

THIRRJE PËR PJESËMARRJE SHKOLLA E OHRIT PËR TË DREJTËN NATYRORE

në temën:

“Gjuha urrejtjes, krimet e urrejtjes dhe format e tjera bashkëkohore të kriminalitetit”

Ohër, 17-23 shtator 2017

Akademia Maqedonase e shkencave dhe arteve (AMSHA) në bashkëpunim me Universitetet “Goce Delçev” – Shtip; “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe Universitetin e Evropës Juglindore, me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Shkup, bëjnë thirrje për pjesëmarrje në **Shkollën e Ohrit për të drejtën natyrore në temën: “Gjuha urrejtjes, krimet e urrejtjes dhe format e tjera bashkëkohore të kriminalitetit”**

Synimi kryesor i kësaj shkolle është avancimi i dijenisë përmes përvijës së përbashkët hulumtuese të studentëve nga cikli i dytë dhe i tretë i studimeve juridike, së bashku me profesorët dhe mentorët e tyre, në fushën penalo-juridike nëpërmjet qasjes integrale. Për më shumë, shkolla poashtu synon ta ngritë vetëdijen e pjesëmarrësve mbi fenomenet dhe efektet e gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes, si dhe dobitë nga diversiteti etnik, gjuhësor dhe fetar për vetë shoqërinë.

Synimi i shkollës verore:

- Avancim të njohurisë përmes eksperiencës hulumtuese të studentëve të ciklin të dytë dhe tretë në studimet e drejtësisë, së bashku me profesorët dhe mentorët e tyre, në fusha të ndryshme juridike përmes qasjes integrale, që bashkon: parimet dhe standardet universale të të drejtave të njeriut, idetë dhe vlerat kryesore të drejtësisë; vlerat demokratike dhe sundimin e së drejtës dhe ligjit; të drejtën pozitive; aplikimin e të drejtës në punën praktike; dhe drejtësinë që ndajnë me aktvendimet e tyre në vetë gjykatat dhe praksën gjyqësore.
- Njohuri dhe zhvillim të eksperiencave të studentëve në studimet post-diplomike (master) dhe studimet e doktoraturës dhe profesorëve të fakulteteve të drejtësisë në shtet dhe rajon, përmes punës së vazhduar dhe kolektive.
- Shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim për projekte të përbashkëta mbi tema të cilat janë pjesë e punës së studentëve dhe studentëve në studimet e doktoraturës.
- Verifikimi i dijenisë së arritur me certifikate dhe diploma përkatëse të cilat do të jenë kyçe në nomenklaturën e diplomave përkatëse të fituara në arsimin e lartë.

Grupi i synuar – studentë në studime post-diplomike (cikli i dytë i studimeve) dhe studentë në studime të doktoraturës (cikli i tretë i studimeve) nga fakultetet e drejtësisë në kuadër të universiteteve shtetërore dhe private në shtet.

Gjithsejtë 20 studentë në studime post-diplomike dhe 5 studentë në studime të doktoraturës do të përzgjidhen nga fakultetet e drejtësisë në kuadër të universiteteve shtetërore dhe private në shtet.

Periudha dhe lokacioni – Shkolla verore do të mbahet në periudhën nga 17 deri më 23 shtator të vitit 2017, në kohëzgjatje prej 7 ditëve. Programi do të zhvillohet në qendrën e AMSHA – vila

“Uranija” në Ohër, përderisa pjesëmarrësit dhe lektorët do të jenë të vendosur në hotelin “Silex” në Ohër.

Gjuha e punës – Gjuha maqedonase, me njohuri të domosdoshme të gjuhës angleze.

Temat – Shkolla verore do të përpunojë tema mbi gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes, korrupsioni dhe keqpërdorimi i pushtetit, tema të caktuara mbi Ligjin për procedurë penale dhe argumentim juridik, garancitë procedurale mbi të drejtat e të pandehurit, paraburgimi dhe ngjashëm.

Certifikate – Pas mbarimit të programit të shkollës verore, studentët më të mirë në studime post-diplomike dhe pjesëmarrës në Shkollën e Ohrit për të drejtën natyrore do të fitojnë certificate për pjesëmarrje dhe mundësi për të publikuar punën dhe prezantimet e tyre në *on line* botimin e Zbornik, i cili do të publikohet në internet faqen e Qendrës për hulumtime strategjike pranë AMSHA. Punimet e miratuara do të recensohen dhe redaktohen nga anëtarët e Bordit ndërkombëtar programor të shkollës verore.

Mënyra e aplikimit dhe seleksionimi i pjesëmarrësve – Të gjithë studentët e interesuar në studime post-diplomike mund të aplikojnë duke **plotësuar formularin për pjesëmarrje në këtë link:**

<https://goo.gl/forms/SoYbvt6iEYnmCZw63>, përfshirë dhe **Letër motivimi** (jo më të gjatë se një faqe)

Afati për të aplikuar është deri më 25 maj 2017. Seleksionimi do të bëhet në bazë të **kritereve** të dhëna më poshtë:

Studentët e interesuar për pjesëmarrje duhet:

- Të jenë studentë të ciklit të dytë të studimeve të rregullta në fakultetet e drejtësisë në shtet; nga fakultetet shtetërore apo private;
- Të jenë në mundësi të marrin pjesë gjatë tërë kohëzgjatjes së shkollës verore;
- Të shprehin interes për temat dhe motivim personal (përmes një Letre motivimi);
- Të dorëzojnë dokumentacion të kompletuar (formular për pjesëmarrje tërësisht të plotësuar dhe letër motivimi);
- Të kenë njohuri të domosdoshme të gjuhës angleze.

Bordi gjithashtu do t'i konsiderojë dhe **kriteret e më poshtme për përfshirje (inkluzion):**

- Përfaqësimin e barabartë gjinorë;
- Diversitetin etnik dhe kulturor;
- Përfaqësimin gjeografik.

Shënim: Gjatë procesit të seleksionimit mund gjithashtu të merret parasysh dhe suksesi apo nota mesatare e studentit gjatë studimeve deri-diplomike.

Nga shkaku se studentët e ciklit të tretë të studimeve do të fokusohen në studim më të thellë dhe më kompleks të temave të parapara në Shkollën e Ohrit për të drejtën natyrore për këtë vit , të njëjtët do të seleksionohen drejtpërsëdrejti nga ana e mentorëve të tyre, për atë shkak nuk nevojitet të dorëzojnë aplikacione. Madje, pjesë nga hulumtimet e tyre do duhet të jetë në një nga temat e dhëna të shkollës dhe të prezantohen në të njëjtën.

Shpenzime – Shpenzimet për vendosje dhe ushqim për pjesëmarrësit, si dhe shpenzimet për materialet e punës do të bien mbi organizatorët e shkollës verore.

Personi për kontakt: Deniza Bundalevska, e-mail: Deniza.Bundalevska@osce.org